



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 21.01.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për gjyqtarët e gjykatave me juridiksion të përgjithshëm të caktuar në çështje të veçanta në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:10 dhe mbaroi në orën 13:03.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

11. Marçela Shehu

(anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 7. Enida Muceku, Specialiste pranë Sektorit të Suportit të Menaxhimit të Çështjeve.*
- 8. Rezart Alija, EURALIUS.*
- 9. Helios Raveli, EURALIUS.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për gjyqtarët e gjykatave me juridiksion të përgjithshëm të caktuar në çështje të veçanta në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje!

Siç jeni vënë në dijeni, fillojmë mbledhjen e datës 21.01.2020.

Në rendin e ditës, për shkak urgjence janë dy çështje që do merren në shqyrtim nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Fillimisht, të pranishëm janë të gjithë anëtarët e Këshillit.

Le të diskutojmë rendin e ditës dhe çështjet që kemi përfshirë për shkak të urgjencës.

Çështja e parë ka të bëjë me projektvendimin “Për gjyqtarët e gjykatave me juridiksion të përgjithshëm të caktuar në çështje të veçanta në gjykatat e posaçme për

korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Dhe çështja e dytë ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Pa humbur kohë, fillojmë me relatimin e çështjes së parë.

Ia jap fjalën zotit Ilir Toska për relatimin e projekt-aktit të propozuar mbledhjes së Këshillit.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ju paraqet një projektvendim për gjyqtarët e gjykatave me juridiksion të përgjithshëm të caktuar në çështje të veçanta në Gjykatat të Posaçme për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar.

Ky projektvendim merr shkas nga situata që aktualisht gjendet në Gjykatat e Posaçme Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në kushtet kur ato kanë filluar funksionimin e tyre më datë 19 dhjetor 2019, ndërkohë që më herët gjykatat, përpara emërtimit të tyre, pra gjykatat e krimeve të rënda, Këshilli, bazuar në vendimin e tij nr.30, datë 14.02.2019, i dalë në përmbushje të përgjegjësive sipas nenit 4 pika 3 dhe nenit 147, pika 1 dhe 147/a, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka caktuar për çështje të veçanta gjyqtarë nga gjykatat me juridiksion të përgjithshëm.

Aktualisht, nga kërkesat që janë paraqitur nga Gjykatat e Posaçme për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar mbas datës 19 dhjetor 2019, pra ditën kur kanë filluar funksionimin e tyre, rezulton të jenë ende pa u shqyrtuar para tyre 8 çështje gjyqësore të veçanta, në të cilat Këshilli i Lartë Gjyqësor ka caktuar më herët gjyqtarë nga gjykatat me juridiksion të përgjithshëm. Nga ana e Gjykatave të Posaçme për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar është kërkuar që Këshilli të mbajë një qëndrim rreth vijimit të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit ndaj gjyqtarëve të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, në çështje të veçanta ku ata janë caktuar prej Këshillit.

Marrë shkas nga situata e krijuar, Këshilli më herët, në fund të muajit dhjetor, nisur nga fakti që në Gjykatat e Posaçme nuk plotësojnë numrin minimal të përcaktuar nga ligji, pra gjykata e shkallës së parë 16 gjyqtarë dhe gjykata e apelit 11 gjyqtarë, nisur

edhe nga fakti i kërkesave të përcaktuara nga ligji për rekrutimin e gjyqtarëve të këtyre gjykatave, ka kërkuar Ministres së Drejtësisë, po kështu edhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë që të konsiderojnë përmirësimin apo ndryshime në legjislacion për të mundësuar rregullimin e situatës që gjenden këto gjykata në momentin aktual, për të mundësuar plotësimin e numrit të vendeve të tyre dhe për të zgjidhur emergjencat që paraqesin në çështje të caktuara.

Deri në këtë moment ka filluar veprimtaria parlamentare dhe Komisioni i Ligjeve ka filluar të punojë për përmirësimin e ligjit të Statusit, por deri në këtë moment nuk ka ende një produkt konkret.

Nga ana tjetër, në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në çështjet ku janë caktuar gjyqtarë nga gjykatat me juridiksion të përgjithshëm, janë paraqitur edhe kërkesa procedurale që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë themelore të të pandehurve, të cilat nuk janë shqyrtuar ende, ndërsa gjykatat presin një vendimmarrje të Këshillit, lidhur me gjyqtarët e caktuar në këto çështje nga gjyqtarët me juridiksion të përgjithshëm.

Nga ana tjetër, sa i përket skemës së delegimit, mbi të cilën Këshilli mund të operojë për të caktuar gjyqtarë edhe në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, deri në këtë moment nuk ka asnjë gjyqtar që të ketë aplikuar në skemë delegimi. Këshilli, po ditën e sotme ka rishpallur përsëri njoftimin duke kërkuar nga gjyqtarët që të aplikojnë për në skemë delegimi, por kjo mbetet në ditët në vijim nëse do ketë ndonjë kërkesë që Këshilli do duhet ta konsiderojë më pas.

Për momentin jam i detyruar, sa i përket kërkesave procedurale të të pandehurve që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë themelore të tyre, ndërsa është prioritare që gjykatat të marrin një vendim për këto të drejta, Këshilli, sipas propozimit që ka bërë Komisioni, duhet të konsiderojë caktimin më herët të gjyqtarëve nga gjykatat me juridiksion të përgjithshëm, që të shqyrtojnë këto kërkesa.

Pika e I e projektvendimit ka të bëjë me konsideratën që thashë më lart, pra që gjyqtarët e gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, të caktuar më herët nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, vazhdojnë të shqyrtojnë çdo kërkesë procedurale që lidhet me të drejtat

dhe liritë themelore të të pandehurit/eve, në çështjet e veçanta në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si më poshtë: ... Ndërkohë më poshtë janë evidentuar tetë çështjet penale dhe gjyqtarët respektiv nga gjykatat me juridiksion të përgjithshëm që Këshilli ka caktuar më herët pranë ish-Gjykatave të Krimeve të Rënda, sot Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në pikën II të projektvendimit parashikohet një kopje e vendimit duhet t'i njoftohet gjyqtarëve, gjyqtarëve të caktuar pra dhe Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Ndërsa vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky është një prezantim i shkurtër rreth projektvendimit që po ju paraqesim për shqyrtim. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim për projekt-aktin?

Nëse nuk kemi diskutim, atëherë kalojmë në vendimmarrje sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Maksim Qoku: Dakord.

(Vota e zonjës Kadi nuk dëgjohet.)

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Gjyqtarët e gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, të caktuar më herët nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, vazhdojnë të shqyrtojnë çdo kërkesë procedurale që lidhet me të drejtat dhe liritë themelore të të pandehurve, në çështjet e

veçanta në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si më poshtë:

Gjyqtarët Erjon Bani dhe Ardian Kalia, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen penale kundër të pandehurit {...}, i akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 284/1, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal, të regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda).

Gjyqtarët Shefkije Demiraj dhe Kreshnik Omari, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen penale kundër të pandehurit {...}, i akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 333/a, paragrafi i parë, 283/a, paragrafi i parë dhe 334, paragrafi i parë, të Kodit Penal, regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda).

Gjyqtari Erjon Bani, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen penale kundër të pandehurit {...}, i akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a/1-22, 28/4, 333/a/2, 334/1, 278/2 dhe 280 të Kodit Penal, regjistruar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda).

Gjyqtarët Ardian Kalia, Erjon Bani dhe Artan Gjermëni, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen penale kundër të pandehurve {...} dhe {...}, të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal, regjistruar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda).

Gjyqtari Ardian Kalia, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për çështjen penale kundër të pandehurve {...}, etj., të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a/1-22, 28/4, 333/a/2, 334/1, 278/2 dhe 280 të Kodit Penal, të regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda).

Gjyqtari Sokol Tona, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen penale kundër të pandehurit {...}, i akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 79/c i

Kodit Penal, regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda).

Gjyqtarët Etleva Temo dhe Artur Kalaja, respektivisht të Gjykatës së Apelit Korçë dhe të Gjykatës së Apelit Tiranë, në çështjen penale kundër të pandehurve {...} etj., të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 109/b/1 dhe 28/4, 238 dhe 28/4, 152/1, 333/a/1 dhe 334/1 të Kodit Penal, regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda).

Gjyqtarët Genti Shala, Valdete Hoxha dhe Asim Vokshi, të Gjykatës së Apelit Tiranë, në çështjen penale kundër të pandehurit {...}, i akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 109/b/1, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal, të regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda).

Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarëve dhe Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 21.01.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:10 dhe mbaroi në orën 13:03.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 7. Enida Muceku, Specialiste pranë Sektorit të Suportit të Menaxhimit të Çështjeve.*
- 8. Rezart Alija, EURALIUS.*
- 9. Helios Raveli, EURALIUS.*

RENDI I DITËS:

2. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, e cila edhe kjo ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Lidhur me relatimin e këtij projekt-akti, fjalën ia jap përsëri sërish zotit Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, deri më datë 20 janar të vitit 2020 janë paraqitur kërkesa nga 15 gjykata apeli apo rrethesh gjyqësore. 7 nga këto gjykata janë nga ato gjykata që ne kemi shpallur për t'u plotësuar nga magjistratët e emëruar më datë 9 janar dhe të cilët në ditët në vijim do bëjmë edhe emërimet e tyre. Kështu që, kemi konsideruar që për këto 7 gjykata, kërkesat që ato kanë paraqitur, t'i trajtojmë në një

moment të dytë, mbasi të kemi ezauruar caktimin e përhershëm të magjistratëve të emëruar më datë 9 janar. Mbase shumica e këtyre kërkesave plotësohen përmes caktimit të këtyre magjistratëve. Vetëm ndonjë kërkesë e veçantë mbetet të trajtohet nga Këshilli në kuadër të caktimit të gjyqtarëve në gjykata të tjera ku ushtrojnë funksionin.

Sa i përket 8 gjykatave që do duhet të trajtojmë kërkesat për çështjet që ata janë në nevojë, janë 4 gjykata apeli dhe 4 gjykata rrethesh gjyqësore.

Konkretisht janë: Gjykata e Apelit Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Gjirokastrë; ndërsa nga gjykatat e rretheve gjyqësore janë: Kurbin, Pukë, Gjirokastrë dhe Kavajë.

Përpara se të vijojmë me procedurat e shortit, kemi propozim për sa i përket radhës së këtyre procedurave, që të ndiqet fillimisht për gjykatat e apeleve, fillimisht Gjykata e Apelit Shkodër, më pas Durrës, më pas Vlorë dhe në fund Gjykata e Apelit Gjirokastrë. Ndërsa sa i përket gjykatave të rretheve gjyqësore, fillojmë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, më pas për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, më pas për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe në fund për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Jeni dakord me radhën e procedurave të shortit?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, vazhdojmë me çështjet në nevojë për **Gjykatën e Apelit Shkodër**.

Gjykata e Apelit Shkodër ka paraqitur nevojë në 8 çështje gjyqësore, nga të cilat 4 në lëndë penale dhe 4 në lëndë civile.

Në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit sipas nenit 45 të ligjit të Statusit për shkak të padisponueshmërisë mungesës së gjyqtarëve në skemë delegimi. Po kështu është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve sipas nenit 46 të ligjit të Statusit, për sa kohë nevoja e identifikuar e gjykatës në këtë rast konsiston në gjykimin e numrit të kufizuar të çështjeve gjyqësore të veçanta, çka do të thotë që dobia që sjell transferimi i përkohshëm i jo më pak se tre gjyqtarëve, krijon efekt negativ shumë më të madh në gjykatën nga gjyqtarët do duhet të transferohen. Për rrjedhojë është i aplikueshëm zbatimi i mekanizmit të caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë

tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, sipas vendimit 30/2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, referuar të cilit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohet për gjykimin e 8 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 8 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 7.

Në opsion të pranimit të propozimit si më lart, propozimet vijuese të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës janë:

Për çështjet civile: Për çështjen nr.8, për të cilat kërkohen 2 gjyqtarë, si gjyqtarët të përzgjedhur nga shorti të konsiderohen gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që janë në trup gjykues me gjyqtaren Flutura Skënderi, e cila është caktuar në këtë çështje më herët. Në këtë rast, gjyqtarja Flutura Skënderi që është në përbërje të trupit gjykues, është dhe relatore e çështjes.

Për 3 çështjet e tjera, ato nr.5, nr.6 dhe nr.7, për të cilat kërkohet 1 gjyqtar, për secilën nga ato ai të përzgjidhet me short ndërmjet tre gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit (*bëhet fjalë për apelin Tiranë*) sipas pikës 1, ku gjyqtari i caktuar për njëren çështje, përjashtohet nga shorti për çështjet e tjera.

Ndërsa sa i përket çështjeve penale: Për çështjen nr.1, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, referuar përbërjes së trupit gjykues aktual në këtë çështje, ku ka gjyqtarë të caktuar nga Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Për çështjen nr.2, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës, referuar formimit aktual të trupit gjykues ku në përbërje të tij ka gjyqtarë të caktuar më herët nga Gjykata e Apelit Durrës.

Për çështjen nr.3, për të cilën kërkohen 2 gjyqtarë, si të përzgjedhur nga shorti të konsiderohen dy gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës të caktuar për çështjen nr.2.

Ndërsa për çështjen nr.4, për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, Komisioni ka këto propozime:

Në shortimin e këtyre çështjeve të përjashtohen nga shorti kryetarët në detyrë i Gjykatës së Apelit Tiranë, Gjykatës së Apelit Durrës dhe Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konkretisht: zoti Ridvan Hado, zoti Desart Avdulaj dhe zonja Nertina Kosova.

Po kështu, në shortimin e këtyre çështjeve për përzgjedhjen e gjyqtarëve nga Gjykata e Apelit Tiranë, të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që nuk janë në detyrë, me leje afatgjatë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht: zonja Evjeni Sinojmeri, zoti Gjin Gjoni. Po kështu, në shortimin e çështjes nr. 1 të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar që janë caktuar më herët për gjykimin e saj, konkretisht gjyqtarët: zonja Albana Boksi dhe zonja Nertina Kosova. Në shortimin e çështjes nr. 2 të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës që është caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht gjyqtarja Anita Mici. Në shortimin e çështjes nr. 4 të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar që caktohet për çështjen nr. 1 dhe në shortimin e çështjes nr. 8 të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë që është caktuar më herët për gjykimin e saj, konkretisht gjyqtarja Flutura Skënderi.

Këto janë propozimet e Komisionit. Nëse jeni dakord, mund të vijojmë me procedurat e shortit.

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, meqenëse Këshilli është dakord me propozimet e Komisionit, vijojmë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Atëherë, sipas propozimit të parë, i bie për çështjen nr. 8 në të cilën është në përbërje të trupit gjykues gjyqtare Flutura Skënderi, gjyqtarët e përzgjedhur janë Artur Gaxha dhe Gramoz Levanaaj, që janë në të njëjtin trup gjykues.

Për tre çështjet e tjera, atëherë kemi çështjen nr. 1579, gjyqtarja e përzgjedhur është Flutura Skënderi. Për çështjen nr. 1066, gjyqtari i përzgjedhur është Artur Gaxha dhe për çështjen 1569, gjyqtari i përzgjedhur është Flutura Skënderi.

Ilir Toska: Atëherë, sa kohë rezultati i shortit nuk është sipas propozimit të miratuar nga Këshilli, pra për secilin gjyqtar duhet të ngarkohet vetëm me një çështje. Për tre çështjet nr. 5, 6 dhe 7, do duhet të përsëritet shorti elektronik.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, përsërite procedurën e shortit për çështjet nr. 5, 6 dhe 7.

Valbona Bako: Atëherë, për çështjen 1579, gjyqtarja e përzgjedhur Flutura Skënderi. Për çështjen 1569, gjyqtari i përzgjedhur Artur Gaxha dhe për çështjen 1066, gjyqtari i përzgjedhur Gramoz Levanaj.

Atëherë, për propozimin e dytë, që është propozimi i dytë, pika 1 dhe pika 4 e relacionit, kemi për çështjen nr. 568 gjyqtare Nure Dreni, ndërsa për çështjen 684, pra që është numri 4 në tabelë, janë gjyqtarët Saida Dollani (relatore), Albana Boksi dhe Nure Dreni (anëtare).

Për çështjen nr. 2 në tabelë kemi të përzgjedhur gjyqtarin Tritan Hamitaj.

Edhe për çështjen nr. 3, gjyqtarët e përzgjedhur janë Anita Mici dhe Tritan Hamitaj.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Shkodër. Vazhdojmë me kërkesat në nevojë në **Gjykatën e Apelit Durrës**.

Gjykata e Apelit Durrës ka paraqitur nevojë në 6 çështje, të cilat 4 civile dhe 2 penale. Kërkohej 1 dhe 2 gjyqtarë.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, duke qenë kështu i aplikueshëm zbatimi i mekanizmit të caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 6 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 6 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Në opsion të pranimit të këtij propozimi, propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Për çështjet civile: Për 2 çështje, ato nr.3 dhe nr.4, për të cilat kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë. Për 2 çështje, ato nr.1 dhe nr.2, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilën nga ato, gjyqtari të përzgjidhet me short nga ata të caktuar sipas pikës 1.

Për çështjet penale: Për 2 çështje, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Referuar këtyre propozimeve, Komisioni ka edhe propozime për përjashtim nga shorti, konkretisht: të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Tiranë, zoti Ridvan Hado. Të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që janë me leje afatgjatë nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, zonja Evjani Sinojmeri dhe zoti Gjin Gjoni. Po kështu, të përjashtohen nga shorti edhe tre gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë që do të caktohen për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në Gjykatën e Apelit Shkodër, që ishin Flutura Skënderi, Artur Gaxha dhe Gramoz Levanaj.

Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Meqë Këshilli është dakord me propozimet e Komisionit, vijojmë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Për çështjen nr. 1417 është gjyqtare Elbana Lluri.

Për çështjen nr. 71 janë gjyqtarët Asim Vokshi dhe Elbana Lluri.

Për çështjen nr. 1425 Asim Vokshi.

Dhe për çështjen nr. 1650 Elbana Lluri, Asim Vokshi.

Për dy çështjet e tjera penale nr. 633 zgjidhet gjyqtari Shkëlqim Mustafa.

Dhe për çështjen 1009 është gjyqtari Shkëlqim Mustafa.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Durrës.

Vazhdojmë me procedurat e shortit me **Gjykatën e Apelit Vlorë**. Gjykata e Apelit Vlorë ka paraqitur nevojë në 12 çështje, nga të cilat 5 janë në lëndë penale dhe 7 janë në lëndë civile. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, duke qenë kështu i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 12 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastrë, Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 12 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 8.

Në opcionin e pranimit të këtyre propozimeve, për hapat e mëtejshme të shortit, Komisioni ka këto propozime:

Për çështjet civile: Për 3 çështje, ato nr.10, nr.11 dhe nr.12, për të cilat kërkohen 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. Në këtë rast, me short, secili nga gjyqtarët caktohet relator në një çështje. Për 3 çështje të tjera, ato nr.6, nr.7, dhe nr.9, për të cilat kërkohet 1 gjyqtar, për secilën nga ato ai të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë të caktuar sipas pikës 1. Për çështjen nr.8, për të cilën kërkohen 2 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë të caktuar sipas pikës 1.

Për çështjet penale: Për 4 çështje, ato nr.1, nr.2, nr.3 dhe nr.4, për të cilat kërkohet 1 gjyqtar, për secilën nga ato ai të përzgjidhet me short ndërmjet 2 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës. Për çështjen nr.5, për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në opcionin e pranimit të këtyre propozimeve, Komisioni ka propozime për

përrjashtimin nga shorti, konkretisht të kryetarët në detyrë të Gjykatës së Apelit Gjyrokastër, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe të Gjykatës së Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konkretisht: z.Dritan Banushi, z.Desart Avdulaj, znj.Nertina Kosova.

Po kështu, propozimi tjetër është që në shqyrtimin e çështjeve civile të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjyrokastër që është anëtare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, konkretisht: znj.Miranda Andoni.

Po kështu, sa i përket çështjes civile nr. 9, propozohet të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjyrokastër që janë caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht: znj.Irena Brahimi, z.Izet Salaj.

Dhe propozimi i fundit është që në shortimin e çështjeve penale nr.1, nr.2, nr.3 dhe nr.4, të përjashtohen nga shorti dy gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës që do të caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Shkodër, që ishin Anita Mici dhe Tritan Hamitaj.

Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Mirë, meqenëse Këshilli është dakord me propozimet e Komisionit, vijojmë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Atëherë, për propozimin e parë, pika 1, 2 dhe 3 – Për çështjen nr. 3020 gjyqtarët janë Irena Brahimi (relatore), Izet Salaj.. Izet Salaj ka dalë dy herë.

(Ribëhet shorti.)

Atëherë për çështjen nr. 345, gjyqtar Enton Dhimitri.

Për çështjen 2200, gjyqtare Irena Brahimi dhe Izet Salaj.

Për çështjen 2533, gjyqtar Enton Dhimitri (relator), Irena Brahimi dhe Izet Salaj (anëtarë).

Për çështjen nr. 320, gjyqtarë Irena Brahimi (relatore), Enton Dhimitri dhe Izet Salaj (anëtarë).

Për çështjen 3020, gjyqtar Izet Salaj (relator), dhe anëtarë Enton Dhimitri dhe Irena Brahimi.

Për çështjen nr. 193, gjyqtar Enton Dhimitri.

Për çështjen 2198, gjyqtare Irena Brahimi.

Atëherë, për propozimin sipas propozimit të dytë, pika 1, që do t'i marrim nga apeli Durrës, përjashtojmë gjyqtarin Tritan Hamitaj dhe Anita Mici dhe kemi: për çështjen nr. 793 gjyqtar Izet Dushaj.

Për çështjen nr. 1100, gjyqtar Valbon Çekrezi.

Për çështjen nr. 318, gjyqtar Izet Dushaj.

Për çështjen 728, gjyqtari Valbon Çekrezi.

Për çështjen e fundit nr. 5, që i marrim nga Gjykata e Apelit të Posaçëm për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, janë Saida Dollani (relatore) dhe anëtarë Nure Dreni dhe Sokol Binaj.

Ilir Toska: Në rastin e një çështjeje në Gjykatën e Apelit Shkodër, u caktua një treshe nga Gjykata e Posaçme, ku relatore ishte Saida Dollani.

Përsëri edhe për çështjen e apelit Vlorë i ka rënë shorti gjyqtares Saida Dollani, përsëri relatore.

Mendoni që duhet ta përsërisim, që të mos jetë e njëjta gjyqtare relatore në çështjet që caktojmë, pra të shpërndahet ngarkesa mes gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Posaçëm? Është edhe një çështje që do të ketë përsëri short dhe ideja është që të marrim se kush nga tre gjyqtarët që caktohen të kenë ngarkesë të barabartë. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, e përsërisim shortin edhe një herë, për shkak se gjyqtare Saida Dollani është caktuar dy herë relatorë për çështjet ku u caktua.

Valbona Bako: Okej! Nga shorti i përsëritur, rezulton Nure Dreni (relatore), dhe anëtarë Albana Boksi dhe Sokol Binaj.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Vlorë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Gjirokastrë**. Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka paraqitur nevojë në 18 çështje, nga të cilat 5 në lëndë penale dhe 13 në lëndë civile.

Për çështjet në nevojë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë është i pazbatueshëm mekanizimi i skemës së delegimit, ndërsa është i padobishëm mekanizimi i transferimit të

përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm zbatimi i mekanizmit të caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 21 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Apelit Korçë, Gjykata e Apelit Vlorë dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 21 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 8, nga të cilët 2 nga Gjykata e Apelit Korçë, 3 nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe 3 nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në vijim të këtyre propozimeve, në opsionin e pranimit të tyre, Komisioni ka këto propozime të tjera:

Për çështjet civile: Për 2 çështje, ato nr.18 dhe nr.19, për të cilat kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short nga Gjykata e Apelit Vlorë. Për 10 çështje, ato nr.6, nr.8, nr.9, nr.10, nr.11, nr.12, nr.13, nr.14, nr.15 dhe nr.16, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilën nga ato ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë. Për 2 çështje, ato nr.7 dhe nr.17, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilën nga ato ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë të caktuar sipas pikës 1. Në këto raste ka gjyqtarë që janë në përbërje të trupit gjykues të caktuar nga Gjykata e Apelit Vlorë. Për 2 çështje, ato nr.20 dhe nr.21, për të cilat kërkohen 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë dhe të Gjykatës së Apelit Vlorë të caktuar sipas pikës 1.

Për çështjet penale: Për 4 çështje, ato nr.2, nr.3, nr.4 dhe nr.5, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilën nga ato ai të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë dhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë të caktuar sipas pikës I/1. Për çështjen nr.1, për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke ruajtur edhe në këtë rast situatën që gjyqtarët që janë caktuar relatorë më herët në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe në Gjykatën e Apelit Vlorë, të mos caktohen relatorë në

këtë rast.

Për sa i përket përjashtimeve nga shorti, kemi propozim që të përjashtohen nga shorti kryetarët në detyrë të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konkretisht: znj.Iliba Bezati dhe znj.Nertina Kosova.

Po kështu, në shortimin çështjes nr.7 të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë që është caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht: znj.Margarita Buhali.

Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Meqenëse Këshilli është dakord, vazhdojmë me procedurën e shortit elektronik.

Valbona Bako: Atëherë, sipas propozimit të parë dhe të pikës 3, për çështjen nr. 146 është gjyqtari Petrit Aliaj.

Për çështjen nr. 93 gjyqtarët Sokol Ngresi dhe Petrit Aliaj.

Për çështjen nr. 181, gjyqtari Sokol Ngresi dhe për çështjen nr. 455, gjyqtarët Petrit Aliaj dhe Sokol Ngresi.

Për pikën 2 të propozimit të parë, kemi gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë të cilët shpërndahen në 10 çështje në këtë mënyrë:

Për çështjen nr. 345, gjyqtari Olsi Xhavella.

Për çështjen nr. 418, Etleva Temo.

Çështja nr. 48, Olsi Xhavella.

Çështja 486, Etleva Temo.

Çështja 366, gjyqtari Olsi Xhavella.

Çështja nr. 367, gjyqtare Etleva Temo.

Çështja 497, gjyqtari Olsi Xhavella.

Çështja 280, gjyqtare Etleva Temo.

450 gjyqtar Olsi Xhavella. Çështja nr. 365 është gjyqtare Etleva Temo.

Për çështjen nr. 138, gjyqtar Olsi Xhavella.

Për çështjen 683, gjyqtari Petrit Aliaj (relator) dhe anëtarë Etleva Temo dhe Sokol Ngresi.

Për çështjen nr. 28, gjyqtari Olsi Xhavella.

Për çështjen nr. 40, gjyqtare Etleva Temo (relatore) dhe anëtarët Petrit Aliaj dhe Sokol Ngresi.

Për çështjen nr. 133, gjyqtar Olsi Xhavella.

Për çështjen nr. 105, gjyqtar Petrit Aliaj.

(Rilexohet edhe një herë shorti për çështjen 683 dhe 40.)

Për çështjen nr. 21 në tabelë, gjyqtarët janë Etleva Temo (relatore), Petrit Aliaj dhe Sokol Ngresi dhe për 1630 është gjyqtari Petrit Aliaj (relator), Etleva Temo dhe Sokol Ngresi (anëtarë).

Tek çështja nr. 1 është gjyqtari Sokol Binaj (relator) dhe anëtarë Nure Dreni dhe Saida Dollani.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Gjirokastër.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin**. Ka paraqitur nevojë në 5 çështje, të cilat janë të gjitha në lëndë penale.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, duke qenë kështu i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime: Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 5.

Në opSIONIN e pranimit të propozimit si më lart, Komisioni ka këto propozime vijuese: Për 3 çështje, ato nr.1, nr.2 dhe nr.3, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilën nga ato ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Mat. Për çështjen nr.5, për të cilën kërkohen 2 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal për Çështjet e Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për çështjen nr.4, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal për Çështjet e Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të caktuar sipas pikës 2.

Propozimet për përjashtimet nga shorti janë vetëm për gjyqtaren Oltjona Goxhaj, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që është me leje lindjeje dhe për kryetarin në detyrë të kësaj gjykate, z. Petrit Çomo.

Kemi propozim të mos përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, zoti Artan Çupi për shkak të ngarkesës së ulët të kësaj gjykate dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të saj.

Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Meqenëse Këshilli është dakord me propozimet e Komisionit, vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Sipas propozimit të parë, për çështjen me nr. 226 është gjyqtari Artan Çupi i përzgjedhur.

Për çështjen nr. 586 është gjyqtari Rexhep Karaj.

Dhe për çështjen nr. 43 është gjyqtari Ali Koleci.

Për propozimin nr. 2 dhe nr. 3, për çështjen nr. 5 që kërkohen 2 gjyqtarë, janë të përzgjedhur gjyqtarët Bedri Qori dhe Kreshnik Omari, ndërsa për çështjen nr. 4 që kërkohet 1 gjyqtar, gjyqtari i përzgjedhur është Bedri Qori.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit edhe për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë**. Ka paraqitur nevojë në 3 çështje, njëra në lëndë civile dhe dy në lëndë penale.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të

veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e këtyre 3 çështjeve, të jetë 2.

Në opsionin e pranimit të këtyre propozimeve, propozimet vijuese të Komisionit janë që: për 1 çështje civile, atë nr.1, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Për 2 çështje penale, ato nr.2 dhe nr.3, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Përfundimisht nga shorti, Komisioni ka vetëm propozim të përjashtohet kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, zoti Arbër Çela.

Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Mirë, meqenëse Këshilli është dakord me propozimet e Komisionit, vijojmë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Atëherë, sipas propozimit të parë, për çështjen nr. 1, gjyqtari i përzgjedhur është Hasan Selimi.

Për çështjen nr. 2 dhe nr. 3 në tabelë, gjyqtarët e përzgjedhur janë Sokol Shehu (gjyqtari).

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë**, e cila ka paraqitur nevojë për 1 çështje që është në lëndë penale. Kërkohet 1 gjyqtar.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme,

referuar të cilit Komisioni i Zhvillimi të Karrierës ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

I vetmi propozim është që të përjashtohen nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë që është caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, që është z. Sokol Pina. Po kështu të përjashtohet nga shorti edhe gjyqtarja e kësaj gjykate, pra e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, që ka pengesë ligjore për gjykimin e çështjes, zonja Nevrie Duka.

Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Meqenëse Këshilli është dakord, vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Për çështjen nr. 322 gjyqtarja e përzgjedhur është Suela Xhani.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për gjykatën e fundit, **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë**. Ka paraqitur nevojë vetëm në 1 çështje në lëndë civile. Kërkohet 1 gjyqtar.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, duke qenë i aplikueshëm zbatimi i mekanizmit të caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimi të Karrierës ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet gjyqtari që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje, të jetë 1.

Kemi edhe një propozim për përjashtim nga shorti të kryetarit në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Markelian Koça.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Vazhdojmë atëherë procedurat e shortit elektronik, meqenëse Këshilli është dakord.

Valbona Bako: Për çështjen nr. 44 përzgjidhet gjyqtarja Flora Hasimi.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit edhe për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe të gjithë procedurat e shortit për gjykatat në nevojë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, kemi çështje të tjera për të diskutuar?

Nëse jo, unë do doja në fakt t'i bëja thirrje administratës dhe Komisionit të Zhvillimit të Karrierës për të riaktivizuar skemën e delegimit, duke përfshirë gjykatën e re, Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Kjo skemë të bëhet brenda ditës së sotme aktive, duke i lënë afat të gjithë gjyqtarëve që të shprehin interes për të aplikuar në këtë skemë.

Nëse s'keni ndonjë gjë tjetër, unë mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor